

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

INSTALIM DHE MIRËMBAJTJE E LINJAVE TË TENSIONIT TË ULËT DHE TENSIONIT TË LARTË

Niveli III i KSHK
(1 vjeçar)

(Në drejtimin mësimor “Elektroteknikë”)

Kodi: E2-III-20

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2020

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të tensionit të ulët (TU) dhe tensionit të lartë (TL)”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Elektroteknik”.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK.

III. Plani mësimor për profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Elektroteknik”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Elektroteknik”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me punimet për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave elektrike të tensionit të ulët dhe të tensionit të lartë, nënstationeve dhe centraleve elektrike”.*

Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;

- mbështetje për t'u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t'i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t'u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t'u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Elektroteknik”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.

- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në punimet e instalimit dhe mirëmbajtjes së linjave të TU dhe TL
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të zbatojë standartet teknike të shfrytëzimit të impianteve dhe të pajisjeve të rrjetave TU-TL
- Të interpretojë skemat primare të centraleve dhe nënstacioneve elektrike
- Të interpretojë skemat sekondare të centraleve dhe nënstacioneve elektrike
- Të zbatojë rradhën e punës për manovrimet në qarqet primare
- Të kryejë kolaudimin e aparateve matëse, mbrojtëse dhe aparateve të tjera elektrike
- Të kryejë instalimin e një koke kablli të tensionit të lartë
- Të kryejë instalimin dhe mirëmbajtjen e elementeve të veçanta të pajisjeve të një impianti shpërndarës TU/TL
- Të kryejë mirëmbajtjen e pajisjeve të centraleve dhe e nënstacioneve elektrike
- Të instalojë dhe mirëmbajë impiantin e tokëzimit dhe të rrufepritësit
- Të kryejë kontrollin e mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës
- Të kryejë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kryerjes së punimeve
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë e të mbrojtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me çertifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), në operatorët e sistemit të transmetimit (OST) dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes (OSSH) të energjisë elektrike, si edhe në biznese private të cilat ofrojnë shërbime të instalimit dhe shfrytëzimit të pajisjeve të rrjetave të TU dhe TL. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për

vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

I. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK

Plani mësimor për profilin mësimor “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-11-194-11	Pajisje centralesh dhe mbrojtje rele	3
3	L-11-195-11	Tensione te larta	1
4	L-11-196-11	Teknikë sigurimi në instalimin dhe mirëmbajtjen e linjave TU dhe TL	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-11-529-11	Kolaudimi i aparateve elektrike	81
2	M-11-530-11	Instalimi i një koke kablli të tensionit të lartë	66
3	M-11-537-11	Bashkimi i kabllave të TL në rast zgjatjeje apo dëmtimi	33
4	M-11-531-11	Instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të një impianti shpërndarës TU/TL	75
5	M-11-532-11	Mirëmbajtja e pajisjeve të centraleve dhe e nënstacioneve elektrike	39
6	M-11-533-11	Instalimi dhe mirëmbajtja e impiantit të tokëzimit dhe rrufepritësit	36
7	M-11-534-11	Kontrolli i mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse	30
8	M-11-538-11	Instalimi i pajisjeve të impiantit mbrojtës të kabinës elektrike të TM/TU	48
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-11-535-11	Montimi i një linje ajrore të tensionit të lartë	102
2	M-11-536-11	Montimi i një impianti shpërndarës 20/0.4 kV	102

		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)
--	--	-------------------------	---------------------------------

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e riparimit dhe të mirëmbajtjes së linjave të TU dhe TL, dhe u jepet çertifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III i KSHK.

VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Çertifikatën e aftësimin profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi në:
 - lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - dy provimet përfundimtare të Nivelit III i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-20). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë**

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	4 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	4 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë

Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	5 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	5 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë

2. Lënda “Pajisje centralesh dhe mbrojtje relè” (L-11-194-11). Kl. 12 – 102 orë

• Synimet e lëndës “Pajisje centralesh dhe mbrojtje relè”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Pajisje centralesh dhe mbrojtje relè”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të klasifikojnë konsumatorët e energjisë elektrike sipas tensionit dhe rëndësisë;
- Të shpjegojnë rolin dhe parimin e punës e pajisjeve çkyçëse të tensionit të ulët dhe të lartë
- Të shpjegojnë veprimin e rrymës së pajisjeve shkyçëse të TU dhe TL;
- Të përshkruajnë efektet e kalimit të rrymës në përcjellës;
- Të përshkruajnë standardet kryesore teknike shqiptare dhe evropiane në instalimet dhe mirëmbajtje të linjave të TU dhe TL;
- Të listojnë elementet për ndërtimin e rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm, elektrik të TU e TL.
- Të modelojnë linjen e transmetimit të energjisë në rrjetat e TU dhe TL;
- Të argumentojnë përzgjedhjen e seksionit të përcjellësve dhe kablllove në bazë të ngarkesës
- Të përshkruajnë mënyrat e bashkimit të kablllove sipas standardeve;
- Të klasifikojnë tipet e shtyllave sipas tensionit dhe rëndësisë.
- Të shpjegojnë sistemin energjetik, prodhim, transmetim, shpërndarje deri tek konsumatori;
- Të shpjegojnë shndërrimet energjetike që ndodhin në centrale elektrike;
- Të tregojnë kushtet teknike që zbatohen në montimin e pajisjeve elektrike në centrale dhe nënstacione;
- Të interpretojnë skemat parësore të centraleve dhe nënstacioneve elektrike;
- Të shpjegojnë mënyrën e plotësimit të nevojave vetjake të centraleve dhe nënstacioneve elektrike;
- Të shpjegojnë skema të ndryshme dytësore të centraleve dhe të nënstacioneve dhe parimin e punës së tyre;
- Të shpjegojnë diagramet e ngarkesës;
- Të shpjegojnë lidhjen e shkurtër dhe pasojat e saj;
- Të shpjegojnë rolin e mbrojtjes rele;
- Të shpjegojnë skemat funksionale të mbrojtjes së rrymës dhe t’i analizojë ato;
- Të shpjegojnë rolin e rrymës operative dhe mënyrat e përfimit të saj;
- Të përshkruajnë mbrojtjet e transformatorit të fuqisë dhe skemat përkatëse;
- Të përshkruajnë mbrojtjet e gjeneratorit dhe motorit elektrike skemat përkatëse;
- Të përshkruajnë mbrojtjet e linjave dhe skemat përkatëse;

- Të listojnë elementet dhe pajisjet e mbrojtjes, matjeve dhe sinjalizimeve të rrjetit elektrik
- Të shpjegojnë rolin e sistemeve automatike nëpërmjet analizës së skemave përkatëse
- Të shpjegojnë skemat e lëshimit me radizator;
- Të përshkruajnë humbjet e fuqisë dhe energjisë në rrjet dhe shkaqet kryesore të tyre;
- Të përshkruajnë mënyrat e rregullimit të tensionit dhe të përmirësimit të cos ϕ ;
- Të argumentojnë rolin e baterive akumulatore;

Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Pajisje centrale dhe mbrojtje relè”, kl. 12- 102 orë:

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sistemin elektroenergjitik	3 orë
Tema 2	Elementet për ndërtimin e rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm elektrik të TU-TL	5 orë
Tema 3	Kriteret për zgjedhjen dhe kontrollin e përcjellsave, kabllave dhe shinave. Linjat kabllore të rrjetave elektrike	5 orë
Tema 4	Furnizimi me energji elektrike. Sistemi, rrjetet dhe konsumatorët.	6 orë
Tema 5	Njohuri për pajisjet dhe elementet e tensionit të ulët	4 orë
Tema 6	Njohuri për pajisjet dhe elementet e tensionit të lartë	6 orë
Tema 7	Centralet elektrike dhe sistemi energjitik njohuri të përgjithshme	4 orë
Tema 8	Nderimi i instalimeve të shpërndarjes dhe vendosja e pajisjeve elektrike në centrale dhe nënstacione	4 orë
Tema 9	Skemat parësore e dytesore të centraleve dhe nënstacioneve elektrike	8 orë
Tema 10	Nevojat vetjake të centraleve dhe nënstacioneve elektrike	4 orë
Tema 11	Lidhja e shkurtër .	8 orë
Tema 12	Mbrojtja relè dhe automatika në rrjetat e furnizimit me energji elektrike .	8 orë
Tema 13	Rryma operative	4 orë
Tema 14	Mbrojtja e rrymës	6 orë
Tema 15	Njohuri për transformatorët e fuqisë	4 orë
Tema 16	Mbrojtja e transformatorëve të fuqisë	4 orë
Tema 17	Mbrojtja e gjeneratorëve dhe motorëve elektrike	8 orë
Tema 18	Mbrojtja e linjave ajrore dhe kabllore	4 orë
Tema 19	Diagnostikimi i pajisjeve e rrjeteve dhe n/stacioneve	4 orë
Tema 20	Përdorimi i Tik në projektimin i rrjetave shpërndarëse të tensionit të ulët.	3 orë

3. Lënda “Tensione të larta” (L-11-195-11). Kl. 12 - 34 orë

- Synimet e lëndës “Tensione të larta”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Tensione të larta”, klasa 12, nxënësit duhet:

Të shpjegojnë karakteristikat e fushës elektrike të krijuar në pajisje të ndryshme elektrike;
 Të shpjegojnë procesin e shkarkimit në gaze;
 Të analizojnë vetitë e dielektrikëve të ngurtë dhe të lëngët;
 Të analizojnë mënyrën e izolimit të pajisjeve elektrike të tensionit të lartë;
 Të analizojnë proceset valore dhe efektet e tyre në linjat dhe transformatorët;
 Të analizojnë proceset e mbitensioneve atmosferike dhe mënyrën e mbrojtjes prej tyre;
 Të analizojnë mbitensionet e komutimit

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Tensione të larta”, kl.12 - 34 orë**

Tema 1	Njohuri mbi fushën elektrike në pajisjet elektrike	4 orë
Tema 2	Shkarkimi në gaze	6 orë
Tema 3	Llojet e veçoritë e dielektrikëve të ngurtë dhe të lëngët	3 orë
Tema 4	Mënyrat e izolimit të pajisjeve elektrike të tensionit të lartë e të ulët	4 orë
Tema 5	Proceset valore në linjat elektrike dhe transformatorët	8 orë
Tema 6	Mbi tensionet atmosferike dhe mbrojtja e linjave elektrike të transmetimit dhe nënstationeve prej tyre	6 orë
Tema 7	Mbi tensionet e komutimit	3 orë

4. Lënda “Teknikë sigurimi në instalimin dhe mirëmbajtjen e linjave të TU dhe TL” (L-11-196-11). Kl. 12 - 34 orë

- **Synimet e lëndës “Teknikë sigurimi në instalimin dhe mirëmbajtjen e linjave TU dhe TL”, kl. 12**
 - Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknikë sigurimi në instalimin dhe mirëmbajtjen e linjave TU dhe TL”, klasa 12, nxënësit duhet:
 - Të shpjegojnë efektet dhe pasojat e kalimit të rrymës elektrike në trupin e njeriut
 - Të listojnë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë në instalime dhe mirëmbajtje të linjave të TU dhe TL si dhe mënyrën e shmangies së tyre;
 - Të interpretojnë rregullat për dhënien e ndihmës së parë për personat që goditen nga rryma elektrike
 - Të listojnë masat mbrojtëse për mos rënien nën tension gjatë instalimit dhe mirëmbajtjes të linjave të TU dhe TL;
 - Të përshkruajnë masat dhe rregullat për garantimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë veprimtarisë në instalime dhe mirëmbajtje të linjave të TU dhe TL;
 - Të përshkruajnë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
 - Të listojnë pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive që përdoren gjatë punës;
 - Të përshkruajnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
 - Të përshkruajnë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e ndotjes;
 - Të shpjegojnë rëndësinë e kryerjes së punimeve në bazë të urdhrit të punës;
 - Të shpjegojnë rolin e tokëzimit mbrojtës dhe kushtet e realizimit të tij;
 - Të shpjegojnë rolin e nulifikimit mbrojtës dhe kushtet e realizimit të tij;

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknikë sigurimi në instalimin dhe mirëmbajtjen e linjave TU dhe TL”, kl.12 - 34 orë

Tema 1	primi i rrymës të elektrike në organizmin e njeriut.Mjetet mbrojtëse	3 orë
Tema 2	Shkaqet e demtimit ngarryma elektrike ne linjat e energjise te TU - TL	5 orë
Tema 3	Menyrat e dhëniessë ndihmës së parë të goditurve nga rryma elektrike në linjat e energjisë të TU - TL	3 orë
Tema 4	Rregullat emasat përgjithshme për mbrojtjen dhe sigurinë nëpunë,në instalimin dhe mirëmbajtjen e linjave të TU dhe TL	5 orë
Tema 5	Masat mbrojtëse konstruktive, teknike dhe organizative në rrjetat elektrike të TU e TL	3 orë
Tema 6	Masat konstruktive dhe organizative të mbrojtjes në instalimet e shpërndarjes dhe të transformimit të TU e TL	5 orë
Tema 7	Tokëzimi mbrojtës në instalimin e linjave të TU dhe TL	5 orë
Tema 8	Neutrizimi mbrojtës në instalimin e linjave të TU dhe TL	5 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Kolaudimi i aparateve elektrike”

Drejtimi: Elektroteknik
Profili: Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KOLAUDIMI I APARATEVE ELEKTRIKE	M-11-529-11
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë për të kolauduar pajisjet matëse dhe mbrojtëse (kontaktor elektrik, rele të ndryshme, aparate matës) dhe pajisje të tjera gjatë marjes në dorëzim dhe gjatë shfrytëzimit të centraleve dhe nënstacioneve.	
Kohëzgjatja e modulit	81 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Elektrotekniki integruar me elektronikë”, niveli II i KSHK.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), procedurat e vlerësimit

RM 1 Nxënësi kolaudon ampermetrin

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejt mjetet dhe materialet e punës për kolaudimin e ampermetrit
- të kontrollojë ampermetrin nga ana e jashtme
- të verifikojë karakteristikat e tij në baze të dhenave të pasaportave
- të masë rezistencën e izolimit me meger 500V
- të masë rezistencën ohmike të bobinës
- të lidhë skemat e kontrollit
- të bëjë korektimet e nevojshme
- të përpilojë aktin e kolaudimit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik
- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Bashkëbisedim profesional

RM 2 Nxënësi kolaudon voltmetrin

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejt mjetet dhe materialet e punës për kolaudimin e voltmetrit
- të kontrollojë voltmetrin nga ana e jashtme
- të verifikojë karakteristikat e voltmetrit në bazë të dhenave të pasaportave
- të masë rezistencën e izolimit me meger 500V
- të masë rezistencën omike të bobinës

- të ngreje skemat e kontrollit
- të bëjë korrektimet e nevojshme
- të përpilojë aktin e kolaudimit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik
- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

RM 3 Nxënësi kolaudon watmetrin

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejt mjetet dhe materialet e punës për kolaudimin e watmetrit
- të kontrollojë watmetrit nga ana e jashtme
- të verifikojë karakteristikat e watmetrit në baze të dhenave të pasaportave
- të masë rezistencën e izolimit me meger 500V
- të masë rezistencën omike të bobinës
- të lidhë skemën e kontrollit
- të bëjë korrektimet e nevojshme
- të përpilojë aktin e kolaudimit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik
- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

RM 4 Nxënësi kolaudon kontatorin matës të energjisë elektrike

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejt mjetet dhe materialet e punës për kolaudimin e kontatorit matës të energjisë elektrike
- të kontrollojë kontatorin matës të energjisë elektrike nga ana e jashtme
- të verifikojë karakteristikat e kontatorit matës të energjisë elektrike në baze të dhenave të pasaportave
- të masë rezistencën e izolimit me meger 500V
- të masë rezistencën ohmike të bobinës
- të lidhë skemën e kontrollit
- të bëjë korrektimet e nevojshme
- të përpilojë aktin e kolaudimit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik
- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

RM 5 Nxënësi kolaudon transformatorin e rrymës

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës për kolaudimin e TR të rrymës.
- të përzgjedhë drejt veglat dhe materialet e punës për kolaudimin e TR të rrymës.
- të hapë kapakun e transformatorëve dhe të kontrollojë gjendjen e përgjithshme të tij.
- të verifikojë karakteristikat e transformatorit me ato që përcaktohen në pasaportë.
- të kontrollojë morsetat dhe zbarat e hyrjes.
- të kontrollojë gjendjen e izolatoreve kalues dhe zbarat lidhese të tyre pasi i është hequr kapaku.
- të mase rezistencën e izolacionit me meger 500 dhe 2500
- të kontrollojë lidhjet sipas skemes.
- të masë qëndrueshmërinë elektrike me tension të ngritur.
- të masë rezistencën ohmike.
- të masë koeficientin e transformimit
- të kontrollojë polaritetin e pështjellave dhe të nxjerrë karakteristikën Volt-Ampere
- të kontrollojë qarqet e rrymës së mbrojtjes dhe të matjes deri në panelin e mbrojtjes dhe të komandimit
- të mbyllë transformatorin dhe të bëjë provën e tij
- të përpilojë dokumentacionin e kolaudimit
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
- të pastrojë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

RM 6 Nxënësi kolaudon transformatorin e tensionit

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës për kolaudimin e transformatorit të tensionit
- të përzgjedhë drejt veglat dhe materialet e punës për kolaudimin e transformatorit të tensionit
- të hapë kapakun e transformatorit të tensionit dhe të kontrollojë gjendjen e përgjithshme të tij
- të verifikojë karakteristikat e transformatorit të tensionit me ato që përcaktohen në pasaportë
- të masë rezistencën e izolacionit me meger 500 dhe 2500V

- të kontrollojë morsetat dhe zbarat e hyrjes
- të kontrollojë gjendjen e izolatoreve kalues dhe zbarat lidhëse të tyre pasi i është hequr kapaku.
- të mase rezistencën ohmike
- të masë koeficientin e transformimit
- të kontrollojë lidhjet sipas skemës
- të masë qëndrueshmërinë elektrike me tension të ngritur
- të kontrollojë polaritetin e pështjellave dhe të nxjerë karakteristikën Volt-Amper
- të kontrollojë qarqet e rrymës të mbrojtjes dhe të matjes deri në panelin e mbrojtjes dhe të komandimit
- të mbyllë transformatorin dhe të bëjë provën e tij
- të përpilojë dokumentacionin e kolaudimit
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

RM 7 Nxënësi kolaudon relenë e rrymës

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin e punës kolaudimin e relesë së rrymës
- të përzgjedhë drejt veglat dhe materialet e punës për kolaudimin e relesë së rrymës
- të përpilojë skemat për çdo kontroll e matje
- të kontrollojë relenë e rrymës nga ana e jashtme dhe të verifikojë të dhenat e pasaportës
- të kontrollojë gjendjen e sustave mekanike
- të masë hapsirën ajrore
- të mase rezistencën ohmike të bobinës
- të kontrollojë gjendjen e kontakteve dhe të bëjë pastrimin dhe mbushjen e tyre
- të mase rezistencën e izolimit me meger500 V
- të kontrollojë rrymen e veprimt dhe të kthimit për relete elektromagnetike të rrymës
- të bëjë korektimet përkatëse të relesë së rrymës
- të hartojë aktin e kolaudimit
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
- të pastrojë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

RM 8 Nxënësi kolaudon relenë e tensionit

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës për kolaudimin e relesë së tensionit
- të përzgjedhë drejt veglat dhe materialet e punës për kolaudimin e relesë së tensionit
- të përpilojë skemat për çdo kontroll e matje
- të kontrollojë relenë e tensionit nga ana e jashtme dhe të verifikojë të dhënat e pasaportës
- të kontrollojë gjendjen e sustave mekanike
- të masë hapsirën ajrore
- të masë rezistencën ohmike të bobines
- të kontrollojë gjendjen e kontakteve dhe të beje pastrimin dhe mbushjen e tyre
- të masë rezistencën e izolimit me meger 500 V
- të masë rezistencën ohmike
- të bëjë korrektimet përkatëse të relesë së tensionit
- të hartojë aktin e kolaudimit
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

RM 9 Nxënësi kolaudon relenë e kohës

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës kolaudimin e relesë së kohës
- të përzgjedhë drejt veglat dhe materialet e punës për kolaudimin e relesë së kohës
- të përpilojë skemat për çdo kontroll e matje
- të kontrollojë relenë e kohës nga ana e jashtme dhe të verifikojë të dhënat e pasaportës
- të kontrollojë gjendjen e sustave mekanike
- të masë hapsirën ajrore
- të masë rezistencën ohmike të bobines
- të kontrollojë gjendjen e kontakteve dhe të bëjë pastrimin dhe mbushjen e tyre
- të masë rezistencën e izolimit me meger 500V
- të llogaritë kohën e veprimit të releve të kohës
- të bëjë korrektimet përkatëse të releve
- të hartojë aktin e kolaudimit
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

- të pastrojë vendin epunës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet labororet e kontrollit te pajisjeve matese dhe mbrojtese dhe në centrale ose nënstacione ku kolaudohen keto pajisje
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete për skemat qe perdoren per kolaudim;
- përdorimin e veglave dhe pajisjeve per hapjen kontrollin dhe mbylljen e ketyre pajisjeve dhe aparateve,si
- per dokumentimin e rezultateve.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli dhe realizimin praktik të tyre.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisi për kryerjen e kontrolleve
 - Skemat e nevojeshme per kryerjen e kolaudimeve
 - Veglat e nevojeshme per hapjen ,mbylljen dhe lidhjen e ketyre aparateve dhe pajisjeve.
 - Mjete dhe aparate oer realizimin e matjeve te nevojeshme.
 - Materiale pune si: ampermetra,voltmetra,watmetra.rele te tipeve te ndryshme,trasformaotore te rrymes dhe tensionit,etj-
 - Udhëzuesa, rregullore, manuale teknike etj.
-

2. Moduli “Instalimi i një koke kabli të tensionit të lartë”

Drejtimi: Elektroteknik

Profili: Instalim dhe mirëmbajtje të linjave të TU dhe TL

Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	INSTALIMI I NJË KOKE KABLLI TË TENSIONIT TË LARTË	M-11-530-11
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer proceset e ndryshme të instalimit një koke kablli të tensionit të lartë termotkurrëse me një dhe tre deje (faze) me izolim XLPE	
Kohëzgjatja e modulit	66 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të kualifikimit në drejtimin mësimor “Elektroteknik”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi instalon kokë kablli të brendshme termotkurrëse me një dell të tensionit 6, 10, 20 kV me izolim XLPE Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përzgjedhë drejt mjetet dhe materialet e punës për realizimin e instalimit të një koke kablli 6kV- të përzgjedhë koken e kabllit të brendshme sipas tensionit dhe seksionit tërthor të përcjellësit- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten- të instalojë saktë një kokë kablli 6kV- të bëjë kontrollin e kokës së kabllit patension- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Bashkëbisedim profesional	
	<p>RM 2 Nxënësi instalon një koke kablli të brendshme 6, 10, 20 kV termotkurrëse me tre deje dhe me izolim XLPE Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për realizimin e instalimit të kokës së kabllit 10kV- të përzgjedhë kokën e kabllit 10 kV sipas standardeve- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten- të viztojë saktë skemën e montimit një dhe shumëvijore.- të instalojë saktë një kokë kablli 6kV- të bëjë kontrollin e daljes kabllore me kokën e re me meger 2500V- të bëjë kontrollin e kokës së kabllit pa tension- të bëjë kontrollin e kokës së kabllit me tension- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm	

- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme
 - të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
 - të pastrojë vendin e punës
- Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli
 - Bashkëbisedim profesional

RM 3 Nxënësi instalon nje koke kabli te jashtme 6, 10, 20 kv termotkurrese me nje dell dhe izolim XLPE.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të për zgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për realizimin e instalimit të kokës së kabllit
- të për zgjedhë kokën e kabllit sipas tensionit dhe seksionit tërthor të përcjellsit.
- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten
- të instalojë saktë kokën e kabllit
- të bëjë kontrollin e daljes kabllore me kokën e re pa tension.
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
- të pastrojë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

RM 4 Nxënësi instalon nje koke kabli te jashtme 6, 10, 20 kV termotkurrese me tre deje me izolim XLPE

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të për zgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për realizimin e instalimit të kokës së kabllit
- të për zgjedhë kokën e kabllit sipas tensionit dhe seksionit tërthor të përcjellsit.
- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten
- të instalojë saktë kokën e kabllit
- të bëjë kontrollin e daljes kabllore me kokën e re pa tension.
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme

- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
- të pastrojë vendin e punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazen prodhuese të shkollës ose pranë grupeve të punës të OSSH
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete për përdorimin e veglave për realizimin e këtij moduli.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisi për instalimin e muftes;
 - Veglat e nevojshme e për përgatitjen e muftes dhe për perfundimin e saj
 - Kompleti i punës në pershtatje me tipin e kabllit
 - Llampe gazi etj
 - Materiale të shkruara
 - Udhëzuesat, rregulloret, manuale teknike etj.
-

3.Moduli “Bashkimi kabllorëve tensionit të lartë në rast zgjatjeje apo dëmtimit;”

Drejtimi: Elektroteknik

Profili: Instalim dhe mirëmbajtje të linjave të TU dhe TL në rast zgjatjeje apo dëmtimi

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	BASHKIMI I KABLLOVE TE TENSIONIT TE LARTE NE RAST ZGJATJEJE APO DEFEKTI	M-11-531-11
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer proceset e ndryshme të bashkimit të kabllit të tensionit të lartë termotkurrëse me një dhe tre deje (faze) me izolim XLPE	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Elektroteknik”, niveli II i KSHK.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), procedurat e vlerësimit

RM 1 Nxënësi instalon dhe mirëmban një thikë ngarkese trefazore 20 kV

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejt mjetet dhe materialet e punës për realizimin e bashkimit të kabllit 6kV.
- të përzgjedhë materialet sipas tensionit dhe seksionit tërthor të përcjellsit.
- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten
- të hapë kabllin në përmasat e vizatimit që të jep bashkimi dy kablllove
- të bashkojë me gilza kabllin 6kV
- të bëjë izolimin me tubat izolues me ngrohje.
- të bëjë kontrollin e kabllit të bashkuar pa tension
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik
- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

RM 2 Nxënësi bashkon kabllin 6, 10, 20 kV termotkurrëse me tre deje dhe me izolim XLPE

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të përzgjedhë drejt veglat dhe materialet e punës
- të përzgjedhë siguresen në varesi të tensionit dhe të rrymes.
- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten

- të analizojë skemën e panelit të ushqimit të të transformatorit të fuqisë
- të përcaktojë drejt rradhën e punimeve që do të kryejë
- të bëjë zëvendësimin e siguresave të tensionit të lartë.
- të bëjë kontrollin e skemës pa tension
- të bëjë kontrollin e skemës me tension
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik
- të mirëmbajë mjedisin

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Bashkëbisedim profesional

Udhëzime për zbatimin e modulit

